




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE**



**RAPORTI VJETOR I PUNËS SE  
DREJTORISË SË SHËNDETËSISË DHE  
MIRËQENIES SOCIALE**

**2025**

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale duke u thirrur në obligimet ligjore (Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale 03L-040/, Statutin e Komunës së Gjakovës 01/ Nr110/04-29365 date 30.12.2022 Ligjin për Shëndetësi 04/L-125.Neni 18/dhe udhëzimet administrative përkatëse/U.A. 04/2020 për Kujdes Paresor Shëndetësor si dhe rregullat tjera ligjore nga (M.SH.P dhe MEF, etj ) në kuadër të angazhimeve të saja ofron këto shërbime:

- Planifikimi dhe orjentimi i strategjisë së Kujdesit Parësor Shëndetësor,
- Vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi parësore,
- Vendosjen e objektivave lokale për KPSH,
- Zhvillimin e buxhetit, bazuar në nevojat lokale, duke iu përmbajtur udhëzimeve të MSH dhe MEF;
- Propozimin e buxhetit dhe zbatimin (jetësimin) e buxhetit,
- Vendosjen dhe mbledhjen e bashkë pagesave brenda kornizës së caktuar nga MSH,
- Sigurimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore,
- Mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike në nivel komunal
- Zbatimin e normave dhe standardeve të infrastrukturës,
- Mbledhjen dhe analizimin e informatave në nivel lokal,
- Shërbehet me informata për të përcaktuar prioritetet lokale dhe objektivat, në përputhje me strategjinë e kujdesit primar shëndetësor,
- Shërbehet me të dhënat e nivelit qendror për të analizuar cilësinë e shërbimeve dhe
- përdorimin efektiv të burimeve,
- Përkujdeset për masat e mbrojtjes shëndetësore që kanë të bëjnë me:
  - aktivitetet e dezinfektimit, dezinfektimit, dhe deratizimit,
- Bashkërenditjen dhe mbikëqyrjen e punëve me QKMF, QMF dhe me Ambulanca në kuadër të KPSH-se,
- Mbarëvajtja e punës në Departamentin e Mjekësisë Familjare:
  - Sektori I Mjekësisë Familjare
  - Njesia e vaksinimit dhe Imunizimit
  - Sektori I Shëndetit Oral dhe Preventiv
  - Sektori Konsultativ dhe Diagnostik
  - Kabineti Radiologjik
  - Sektori I Kujdesit Urgjent
  - Laboratori
- Zbatimin e Rregulloreve që lëshohen nga Departamenti i Shëndetësisë, MSH dhe
- Ndërmarrjen e fushatave sensibilizuese me organizata qeveritare dhe joqeveritare dhe hartimin e marrëveshjeve me to,
- Raportimin mbi ofrimin e shërbimeve dhe të arriturat komunale në lëmin e shëndetësisë;
- Komuna ka të drejtë për të pasur, zhvilluar dhe për të përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda komunës,
- Monitorimin e buxhetit dhe aktiviteteve të Qendrës së Punës Sociale
- Planifikimi dhe shpërndarja e subvencioneve shëndetësore Komunale sipas Rregullores.
- Evidentimin e të dhënave lidhur me të gjitha kategoritë e dalura nga luftërat (invalidët civil dhe të luftës për të zhdukur dhe të burgosur etj .

## **Qëllimi i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**

Ofrimi i shërbimeve në Drejtorinë e DSHMS-së , KPSH-së dhe QPS-së në cilësi dhe sasi për popullatën e Komunës së Gjakovës.

Plotësimi i kërkesave dhe nevojave të banorëve të Komunës për ruajtjen dhe avancimin e shëndetit dhe mirëqenies sociale.

**VIZIONI** Shërbime shëndetësore cilësore dhe të sigurta për të gjithë qytetarët

**MISIONI** Ruajtja e shëndetit, promovimi i mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe ofrimi i shërbimeve cilësore të sigurta, me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financiar dhe kosto-efektive

DSHMS aktivitetet e vet e kryen përmes:

- Sektori I Shëndetësisë
- Sektori I Mirëqenies Sociale
- Qendra për Punë Sociale
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
- Departamenti i Mjekësisë Familjare
- Sektori I Mjekësisë Familjare
- Njësia e SISH
- Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit
- Sektori i Shëndetit Oral dhe Preventiv
- Sektori i Kujdesit Urgjent
- Sektori Konsultativ dhe Diagnostik
- Kabineti Radiologjik
- Laboratori

Personeli i paraparë në DSHMS-së është në këtë përbërje:

- 6 individ në zyre të Dshms-së
- 356 individ në KPSH
- 18 individ në QPS

## **Plani vjetor I punës I DSHMS-se per vitin 2025**

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale gjate periudhës Janar- Dhjetor 2025 ka realizuar një numër te konsiderueshëm aktiviteteve dhe punësh, te cilat i ka pasur te planifikuara me Planin e Punës për vitin 2025.

Fillimisht është bere raportimi dhe vlerësimi i projekteve në proces, ato në përfundim, dhe të tjerat në vazhdimësi ne kuadër të përfundimit te vitit 2024 pranë DSHMS-së.

Është bërë organizimi i punës tek te varurit pranë kësaj drejtorie, duke ofruar udhëzime dhe monitorim i punës se Kujdesit Parësor Shëndetësor -së si dhe Qendrës për Pune Sociale.

DSHMS ka filluar dhe hartuar Planin orientues si Plan te Punës për vitin 2025. Sa i përket aktiviteteve tjera DSHMS ka filluar me procedurat për hartim te specifikacioneve me para masat dhe parallogarite për kontratat e planifikuara për këtë vit fiskal, duke parashtruar kërkesat tek Zyra e Kryetarit për marrjen e vendimeve përkatëse lidhur me projektet ne investime kapitale, mallra dhe shërbime, shërbime shëndetësore dhe aktivitete tjera.

DSHMS ka ofruar mbështetje dhe bashkëpunim te plote me menaxhmentin e QKMF-se.

Janë mbajtur takimet e rregullta ditore, javore e mujore lidhur me kërkesat,aktivitet e planifikuara, bazuar ne nevojat shëndetësore te popullates, bazuar ne politikat e Drejtoratit per Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, konforme ligjeve te percaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

## **Subvencione dhe mbështetja sociale**

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, bazuar ne nenin 13 dhe 58 te ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 44 te ligjit Nr05/L-031 pe Procedurën e Përgjithshme Administrative ka hapur Thirrjen Publike për Subvencionimin ne fushën e Shëndetësisë.

Gjate kësaj periudhe nga data 03.02.2025-03.03.2025 është hapur Thirrje Publike për subvencionim ne fushën e Shëndetësisë, ku janë pranuar aplikacionet për mbështetje financiare, dhe janë realizuar pagesat për këto kategori.

Prioritet ne listën e **përfituesve** i'u është dhënë:

- Personave me sëmundje të rënda, dhe me kosto të lartë të shpenzimeve.
- Personat qe nuk kanë përfituar nga burimet tjera financiare,
- Personat qe nuk kanë përfituar gjate dy viteve te fundit.
- Si dhe personat me kushte të vështira socio-ekonomike

Lista e **jo përfituesve** kryesisht është e përberë nga:

- Përfituesit e viteve te kaluara,
- Si dhe personat te cilat intervenimet mjekësore i kane pasur ne vitet e mëparshme, e cila bie ndesh me kriteret e përcaktuara nga Drejtoria e Shëndetësisë, sipas Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale

Nga total **301** aplikues janë përzgjedhur:

**183-** Përfitues,

**118-**Jo përfitues,

Gjithsejte shuma e parapare e mjeteve për Thirrjen Publike ka qene **60,000.00** Euro.

Po ashtu, gjate vitit 2025, ne baze te kërkesave, më Vendim te Kryetarit te Komunës 01 nr 112/02-29835 te datës 10.06.2025 është mbledhur Komisioni për shqyrtimin e kërkesave te rasteve emergjente ,me sëmundje kancerogjene ne fushën e shëndetësisë.

Nga këto kërkesave deri me tani, është bere shqyrtimin i gjithsejtë 66 kërkesave te qytetareve me sëmundje kancerogjene dhe sëmundje tjera.

Shuma e ndare për këto kërkesa është **34,000.00 euro**

Për gjate vitit 2025, ne baze te Rregullores 04/2017 nga Ministria e Financave mbi Standardet, Kriteret, dhe procedurat e Financimit Publik për ndarjen e subvencioneve te Organizatave Jo Qeveritare, kanë qene te hapura tri Thirrje Publike:

**Thirrja e pare** ka qene e hapur nga data **14.04.2025** ,

Nga realizimi i përfituesve të Thirrjes së parë Publike të Organizatave Jo Qeveritare, shuma e planifikuar ka qenë **37,500.00** euro.

Nga kjo shume kanë përfituar:

- 1.OJQ Medica Kosova **4,000.00** euro
2. OJQ Kryqi i Kuq i Kosovës **3,500.00** euro
- 3.OJQ Instituti për Barazi Gjinore **2,500.00** euro

Ne këtë thirrje janë dhënë gjithsej **10.000.00** euro.

Thirrja e dytë Publike është hapur me datë **26.05.2025**, shuma e parapare e mjeteve të ndara ka qenë **25.000.00** Euro.

Përfitues: OJQ Handikos-Gjakova **25,000.00** euro.

Për shkak të mjeteve të mbetura në dispozicion me datën 08.08.2025 është hapur edhe thirrja e tretë për Subvencionim të OJQ-ve.

Përfitues ka qenë OJQ Its Worth living/ Ia vlen të Jetosh **2,500.00** euro

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për gjatë vitit 2025, ka bërë edhe pagesën e qerave.

Prioritet sipas kriterëve kësaj kategorie, i është dhënë nënave vetushqyese, rastet sociale që nuk kanë kulm mbi koke, dhe rasteve të dhunës në familje.

Vlerësimi i pagesave të qerave bëhet sipas Vendimit të Kryetarit nr 112/02-15370 të datës 16.07.2020 sipas ligjit 03/L 164 mbi Programet e Veçanta të Banimit Social ku është formuar Komisioni prej 3 anëtarëve për verifikim të familjeve që kërkojnë qira.

Kërkesa për pagesë të qerave gjatë vitit 2025 kanë qenë 21, ndërsa është bërë pagesa e qerave për **4 familje** në nevojë.

Është bere trajtimi i shume lendeve, kërkesave , aprovimeve apo edhe refuzimeve gjate këtij viti.

Numri total i lendeve te cilat janë trajtuar gjate vitit 2025 ne DSHMS është **677** gjithsejtë.

- Te Transferuara ne drejtori tjera: **5**
- Te miratuara: **273**
- Te refuzuara: **216**
- Te ndryshme kane qene **147**
- Kërkesa për strehim **17**
- Kërkesa për pagese te qerase **21**
- Aprovime te qerase janë **4**
- Kërkesa për Ndërtim dhe renovim te Shtëpive janë **3**
- Aplikim për verifikim dhe vlerësimit te dokumentacionit për Banim Social: **183**

## **PROJEKTET,AKTIVITETET,SHËRBIMET DHE PUNET E PLANIFIKUARA DHE TE KRYERA NGA DSHMS GJATE VITIT 2025**

| <b>EMRI I PROJEKTIT</b>                                                    | <b>STATUSI I REALIZIMIT</b>                        | <b>VËREJTJE</b> | <b>TOTALI I VLERES</b> |
|----------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|-----------------|------------------------|
| Material për laborator hematologjik- biokimik                              | Kontrata është 3 vjeçare e lidhur me dt 29.12.2023 |                 | 44,358.00 €            |
| Furnizim me material për laborator hematologjik- biokimik ( kontrata e re) | 12.12.2025                                         |                 | 9,600.00 €             |
| Furnizim me barna emergjente                                               | Kontrata është lidhur me 01.02.2024                |                 | 10,000.00 €            |
| Furnizim me material stomatologjik                                         | Kontrate një vjeçare e nënshkruar ne dhjetor 2023  |                 | 13,214.00 €            |

|                                                                 |                                                   |                              |              |
|-----------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|------------------------------|--------------|
| Furnizim me material te shtypur zyrtar                          | Kontrata dy vjeçare është lidhur me 15.02.2023    |                              | 9,179.00 €   |
| Mirembajtja te aparaturave                                      | Kontrata 3 vjeçare e lidhur me 19.03.2024         |                              | 2,512.00 €   |
| Furnizim me pajisje teknologjike                                | Kontrata një vjeçare e lidhur me 08.08.2025       |                              | 7,635.00 €   |
| Mirembajtja dhe rregullimi i karrikave stomatologjike           | Kontrata 3 vjeçare e lidhur me 02.04.2024         |                              | 2,500.00 €   |
| Furnizim me derivate per automjete                              |                                                   |                              | 19,170.00 €  |
| Mirembajtja e automjeteve                                       |                                                   |                              | 10,000.00 €  |
| Furnizim me goma per automjete                                  |                                                   |                              | 772.00 €     |
| Sherbime te sigurimit te automjeteve                            |                                                   |                              | 4,370.00 €   |
| Hartimi projekteve për ndërtim te ulet                          |                                                   |                              | 17,182.00 €  |
| Furnizim, me letër                                              | Kontrata është një vjeçare e lidhur me 19.03.2024 | Kontrate e përbashkët me DKA | 1,823.00 €   |
| Mirembajtja e hapësirave te objekteve shëndetësore KPSH dhe QPS | Kontrate dy vjeçare e lidhur me 13.06.2024        |                              | 163,458.00 € |
| Naft për Ngrohje                                                |                                                   |                              | 1,500.00 €   |
| Telefonia mobile                                                |                                                   |                              | 3,128.00 €   |

## KONTRATA PER SHERBIME

|                                                             |                                               |  |              |
|-------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|--|--------------|
| Mirëmbajtja e objektit/pastrimi i objekteve të KPSH dhe QPS | Kontrate tre vjeçare e lidhur me 02.10.2024   |  | 168,972.00 € |
| Asgjësimi i barnave                                         | Kontrata është lidhur me 13.02.2025           |  | 20,000.00 €  |
| Mirëmbajtja, mbushja e bombolave me gaz medicinal           | Kontrate një vjeçare e lidhur me 28.08.2024   |  | 3,232.00 €   |
| Shërbimet konsulentë, mjek-specialist- radiolog             | Kontrate dy vjeçare e lidhur me dt 18.10.2024 |  | 7,920.00 €   |

## INVESTIMET KAPITALE

|                                                                |                                                  |  |              |
|----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|--|--------------|
| Renovimi dhe mirëmbajtja në Qmf ORIZE, Qmf-DARDANI, Qmf-ERENIK | Kontrata është lidhur në muajin dhjetor 2023     |  | 100.000.00 € |
| Renovimi i Banimit Social Ekzistues                            | Kontrata është dy vjeçare e lidhur me 28.12.2023 |  | 189.988.00 € |
| Ndërtimi i objektit të banimit social ( Faza e dyte)           | Kontrate dy vjeçare e nënshkruar me 28.12.2023   |  | 246,798.00 € |
| Ndërtimi i Shtëpisë për persona të moshuar                     | Kontrate dy vjeçare e nënshkruar me 10.01.2024   |  | 200.000.00 € |

## DSHMS RAPORT FINANCIAR 2025

Ne vazhdim, keni te paraqitur Raportin Financiar te:

- Drejtorisë se Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale
- Kujdesit Parësor Shëndetësor dhe
- Qendra për pune sociale

### Administrata- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenia Sociale

| PERSHKRIMI           | BUXHETI          | SHPENZIMI        | % E SHPENZIMIT |
|----------------------|------------------|------------------|----------------|
| <b>DSHMS</b>         | <b>73,125.34</b> | <b>73,122.18</b> | <b>100</b>     |
| PAGA DHE<br>MEDITJE  | 63,125.00        | 63,125.00        | 100            |
| MALLRA E<br>SHERBIME | 10,000.00        | 9,996.84         | 96.97          |

Me poshtë është pasqyruar Buxheti nga Granti specifik për Shëndetësi Primare.

### KUJDESI PARESOR SHENDETESOR

| PERSHKRIMI                                      | BUXHETI             | SHPENZIMI           | % E SHPENZIMIT |
|-------------------------------------------------|---------------------|---------------------|----------------|
| <b>KPSH</b>                                     | <b>4,831,197.09</b> | <b>4,807,388.79</b> | <b>99.51</b>   |
| PAGA DHE MEDITJE                                | 3,800,504.09        | 3,800,504.09        | 100.00         |
| MALLRA E SHERBIME                               | 630,693.00          | 606,922.10          | 96.23          |
| KOMUNALE                                        | 80,00.00            | 79,962.60           | 96.23          |
| SUBVENCIONE                                     | 30,000.00           | 30,000.00           | 100.00         |
| <b>KAPITALE</b>                                 | <b>290,000.00</b>   | <b>290,000.00</b>   | <b>100.00</b>  |
| RENOVIMI I OBJ.TE QMF-<br>ORIZE, DARDANI,ERENIK | 100,00.00           | 100,00.00           | 100.00         |
| NDERTIMI I OBJEKTIT TE<br>BANIMIT SOCIAL        | 190,000.00          | 190,000.00          | 100.00         |

## QENDRA PER PUNE SOCIALE

| PERSHKRIMI                                 | BUXHETI    | SHPENZIMI   | % E SHPENZIMIT |
|--------------------------------------------|------------|-------------|----------------|
| <b>QPS</b>                                 | 376,641.94 | 376,641.94  | 99.99          |
| PAGA DHE MEDITJE                           | 148,641.04 | 148,641.04  | 100.00         |
| MALLRA E SHERBIME                          | 30,000.00  | 29,988.53   | 99.96          |
| KOMUNALE                                   | 8,000.00   | 7,999.27    | 99.99          |
| SUBVENCIONE                                | 10,000.00  | 9,192.04.00 | 91.92          |
| <b>KAPITALE</b>                            | 190,000.00 | 189,988.10  | 99.99          |
| NDERTIMI I BANIMIT SOCIAL                  | 60,752.35  | 56,798.35   | 93.49          |
| RENOVIMI I OBJ.EKZIST.TE<br>BANIMIT SOCIAL | 190.000.00 | 189,988.10  | 99.99          |

| PERSHKRIMI                             | BUXHETI           | SHPENZIMI         | % E SHPENZIMIT |
|----------------------------------------|-------------------|-------------------|----------------|
| <b>SHERBIMET<br/>REZIDENCIALE</b>      | <b>488,713.51</b> | <b>488,664.14</b> | <b>99.99</b>   |
| PAGA DHE MEDITJE                       | 8,713.51          | 8,713.51          | 100.00         |
| MALLRA E SHERBIME                      | 45,000.00         | 44,950.00         | 99.89          |
| KOMUNALE                               | 5,000.00          | 5,000.00          | 100.00         |
| KAPITALE                               | 430,000.00        | 430,000.00        | 100.00         |
| NDERTIMI ISHTEPISE SE TE<br>MOSHUAREVE | 200,000.00        | 200,000.00        | 100.00         |

**Me poshte eshte paraqitur Raporti financiar I Dshms nga periudha 01.01.202-31.12.2025**

| PERSHKRIMI                                        | BUXHETI           | SHPENZIMI           | SALDO     | % E SHP. |
|---------------------------------------------------|-------------------|---------------------|-----------|----------|
| <b>ADMINISTRATA/10</b>                            | 73,125.34         | <b>73,122.18</b>    | 3.16      | 100.00   |
| PAGA                                              | 63,125.34         | 63,125.34           | -         | 100.00   |
| M E SH                                            | 10,000.00         | 9,996.84            | 3.16      | 99.97    |
| <b>KPSH/10</b>                                    | 4,831,197.09      | <b>4,807,388.79</b> | 23,808.30 | 99.51    |
| PAGA                                              | 3,800,504.09      | 3,800,504.09        | -         | 100.00   |
| M E SH                                            | 630,693.00        | 606,922.10          | 23,770.90 | 96.23    |
| KOMUNALET                                         | 80,000.00         | 79,962.60           | 37.40     | 99.95    |
| SUBVENCIONET                                      | 30,000.00         | 30,000.00           | -         | 100.00   |
| KAPITALET                                         | 290,000.00        | 290,000.00          | -         | 100.00   |
| RENOVIMI I OBJ TE QMF,ORIZE,DARDANI<br>DHE ERENK  | 100,000.00        | 100,000.00          |           | 100.00   |
| NDERTIMI I OBJ.TE B.S.                            | 190,000.00        | 190,000.00          | -         | 100.00   |
| <b>QPS/10</b>                                     | <b>376,641.04</b> | <b>376,616.94</b>   | 24.10     | 99.99    |
| PAGA                                              | 148,641.04        | 148,641.04          | -         | 100.00   |
| M E SH                                            | 30,000.00         | 29,988.53           | 11.47     | 99.96    |
| KOMUNALET                                         | 8,000.00          | 7,999.27            | 0.73      | 99.99    |
| KAPITALET                                         | 190,000.00        | <b>189,988.10</b>   | 11.90     | 99.99    |
| REOVIMI I OBJEKTIT EKSISTUES TE BANIMIT<br>SOCIAL | 190,000.00        | 189,988.10          | 11.90     | 99.99    |
| <b>REZIDENCIALE/10</b>                            | 488,713.51        | <b>488,664.14</b>   | 49.37     | 99.99    |
| PAGA                                              | 8,713.51          | 8,713.51            | -         | 100.00   |
| M E SH                                            | 45,000.00         | 44,950.63           | 49.37     | 99.89    |
| KOMUNALET                                         | 5,000.00          | 5,000.00            | -         | 100.00   |
| KAPITALET                                         | 430,000.00        | 430,000.00          | -         | 100.00   |

|                                           |                     |                     |           |        |
|-------------------------------------------|---------------------|---------------------|-----------|--------|
| NDERTIMI I SHTEPISE PER PERS.TE MOSHUAR   | 200,000.00          | 200,000.00          | -         | 100.00 |
| NDERTIMI I SHTEPISE PER MBROJT.E FEMIJEVE | 230,000.00          | 230,000.00          | -         | 100.00 |
| KPSH/21                                   | 100,000.00          | 99,800.50           | 199.50    | 99.80  |
| SUBVENCIONET                              | 100,000.00          | 99,800.50           | 199.50    | 99.80  |
| QPS/21                                    | 10,000.00           | 9,192.04            | 807.96    | 91.92  |
| SUBVENCIONET                              | 10,000.00           | 9,192.04            | 807.96    | 91.92  |
| KPSH/22                                   | 60,752.35           | 56,798.35           | 3,954.00  | 93.49  |
| NDERTIMI I BANIMIT SOC.FAZA II            | 60,752.35           | 56,798.35           | 3,954.00  | 93.49  |
|                                           |                     |                     | -         |        |
| <b>TOTALI I BUXHETIT</b>                  | <b>5,940,429.33</b> | <b>5,911,582.94</b> | 28,846.39 | 99.51  |
| TE HYRAT E KRIJUARA/2025                  |                     | 108,882.40          |           |        |

## **Gjate vitit 2025 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale ka qene pjese e grupeve punuese si me poshte:**

### **Aktivitetet dhe ngjarjet publike**

- Janë zhvilluar aktivitete sensibilizuese dhe edukative në kuadër të Ditëve Botërore të Shëndetit.
- Është organizuar dhe përcjelle procesi i imunizimit dhe vaksinimit në qendrat shëndetësore.
- Në Qendrën e Mjekësisë Familjare “Ereniku” është hapur për herë të parë Shërbimi i Kujdesit Paliativ, i cili do të ofrojë mbështetje profesionale pacientëve me sëmundje të rënda, si dhe familjeve të tyre në momente sfiduese.

### **Bashkëpunime dhe trajnime**

- Drejtoria ka marrë pjesë në trajnime dhe konferenca profesionale.
- Janë zhvilluar takime me përfaqësues të OJQ-ve partnere si UNICEF, AQH, Save the Children, etj., me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi në fuqi.
- Fale bashkëpunimit për bashkëfinancim me Projektin e Kujdesit Shëndetësor të Qasshëm dhe Cilësor bashkë me Agjencionin Zvicëran për Zhvillim dhe
- Bashkëpunim kanë hyrë në funksion Shërbimet e Kujdesit Paliativ.

### **Marrëveshje institucionale**

- Është vazhduar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Komunës dhe Shoqatës “Bereqeti” për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive për familjet në nevojë.
- Me Mbështetje të OSBE është mbajtur punësoria për ri-draftimin e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për Mekanizimin Koordinues Lokal Kundër Dhunës në Familje
- **Shërbime dhe vizita në terren**
- Janë trajtuar raste sociale të referuara nga QPS, me fokus në mirëqenien e fëmijëve. Kanë filluar vizitat sistematike në shkollat për monitorim dhe promovim të shëndetit publik.
- Është duke u përcjellë implementimi i Planit për të Drejtat e Fëmijëve.
- Është aprovuar statuti i QKMF-së.
- Janë vizituar Qendrat e Mjekësisë Familjare për të monitoruar kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

- **Nga Evidentimi I te dhënave lidhur me të gjitha kategoritë e dalura nga luftërat (invalidët civil dhe të luftës për të zhdukur dhe të burgosur) gjeni te bashkangjitur raportin e punës vitin 2025**

| <b>Kërkesa nga Invalidë te luftës dhe kërkesa për Invalidë civil te Luftës</b>                                     | <b>Numri i vërtetimeve te lëshuara</b> |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|
| <b>Lëshimi i vërtetimeve për viktima civile te luftës</b>                                                          | <b>67 aprovime</b>                     |
| <b>Lëshimi i vërtetimeve për Invalid Civil te luftës</b>                                                           | <b>71 aprovime</b>                     |
| <b>Lëshimi i vërtetimeve për Dëshmore te rene ne luftën e fundit</b>                                               | <b>42 aprovime</b>                     |
| <b>Lëshimi i vërtetimeve për te burgosurit e luftës se fundit ne Kosove</b>                                        | <b>7 aprovime</b>                      |
| <b>Lëshimi i librezave për njerëzit e prekur nga lufta e fundit, me te cilën lirohen nga Sherbime shëndetësore</b> | <b>69 aprovime</b>                     |
| <b>Nga Arkiva e DSHMS janë lëshuar dokumentacion për Invalid te Luftës te viteve 1956 e tutje</b>                  | <b>5 dokumente te aprovuara</b>        |